


Doracak për komitetin shkollor

për të drejtat e fëmijës





Përgatiti: Ardita Kabashi - Hima
Për botuesin: Dukagjin Pupovci
Botues: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Kordinator i projektit: Halim Hyseni
Produksioni: Rrota, www.rrota.com
 Design: Ardian Veliu
 Ilustrimet: Shend Vokshi
 Isuf Shala

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Adresa: Kompleksi i Shkollës "Mileniumi i Tretë"
 rr. "Isa Kastrati", p.n.
 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: + 381 38 244 257
Fax: + 381 38 258 203, lok. 104

www.childrights-ks.org

Katalogimi në botim - (CIP)
 Biblioteka Kombëtare dhe Univerzitare e Kosovës

371.107.1:342.7-053.5(036)2
 342.7-053.5:37(036)1.

Doracak për komitetin shkollor për të drejtat e fëmijës / (Përgaditi Ardita Kabashi-Hima ; Ilustrimet Ardian Veliu]. - Prishtinë : "Dinor MG". 15 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm

1. Kabashi-Hima, Ardita 2. Veliu, Ardian

ISBN 9951-434-07-X

Të gjitha të drejtat e përshtatjes dhe të riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet, në asnjë formë dhe me asnjë lloj mjeti, elektronik apo mekanik, përfshirë fotokopjimin dhe çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe marrjes së informacionit, pa lejen e botuesit.

© 2008 Qendra për Arsim e Kosovës. Të gjitha drejtat e rezervuara. Financuar nga UNICEF.

Hyrje

Ky doracak është përgatitur për ju, fëmijë të dashur.

Shpresoj se do të ju ndihmojë që ta keni më lehtë organizimin e punës për Komitetet shkollore.

Po ashtu shpresojmë se do të ju ndihmojë edhe me ide të shumta të cilat do ti hasni në këtë doracak.

Të gjitha ato që i lexoni në këtë doracak, presim nga ju që ti shfrytëzoni, ti provoni dhe të ju japin ide edhe më të mira rreth organizimit të aktiviteteve.

Përmbajtja e doracakut


- 4 Roli i komiteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
- 5 Çfarë është komiteti shkollor?
- 6 Pse formohen komitetet shkollore?
- 7 Çfarë e bën të njohur komitetin shkollor?
- 8 Informata, informata, informata...
- 9 Si të mbajmë agjendë? Për çka na nevojitet agjenda? Si të përgatitet një agjendë?
- 10 Raportet e komitetit shkollor me këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
- 10 Pjesëmarrja e prindërve në komitetin shkollor
- 11 Mënyra e punës së komitetit shkollor
- 12 Atmosfera dhe relacionet në shkollë
- 13 Rregullat për siguri më të madhe në shkollë
- 13 Adresimi dhe reagimi ndaj dhunës
- 14 Çka të bëjmë ne që të ndihemi të sigurt? Si ta parandalojmë dhunën në shkollë dhe shoqëri? Si ta krijojmë një ambient të bukur për ne?
- 15 Roli i shkollës në punën e komitetit shkollor
- 16 Intervistë me dy nxënës, anëtarë të komitetit shkollor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Roli i komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Komitetet shkollore luajnë një rol shumë të madh për shoqërinë kosovare e në veqanti për mbrojtje e të drejtave të fëmijës. Është një nga mënyrat më të mira, më të lehta dhe më korrekte që fëmijët të jenë të lirë të shprehin mendimet e tyre, brengat e tyre dhe çdo gjë që është në interesin e tyre- në shkollë, në shtëpi dhe në shoqëri.

Po ashtu me anë të komiteteve shkollore nxënësit do të jenë më të njohtuar me prolemet shkollore do të jenë të përfshirë në shumë aktivitete shkollore, partneritet më të madh me drejtuesit e shkollës, stafin e shkollës dhe prindërit.

Komitetet shkollore, kanë për obligim të promovojnë interesat e shkollës dhe të përfshijnë apo të marrin në konsideratë të gjitha kërkesat e nxënësve që kanë të bëjnë me shkollën e poashtu edhe në relacione me prindër dhe mësimdhënës.





Çfarë është komiteti shkollor?

Komiteti shkollor është organ i cili mbron të drejtat e të gjithë fëmijëve në shkollat përkatëse.

Roli kryesor i Komitetit shkollor është fuqizimi i të drejtave të fëmijës duke siguruar mbrojtje dhe respektim të lartë të tyre në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Ky organ duhet themeluar dhe duhet vepruar. Që ky organ të shndërrohet në një levë të fuqishme të promovimit të të drejtave të fëmijës është e domosdoshme një qasje kreative, një përkushtim i fuqishëm, shkallë e lartë e humanizmit dhe marrëdhënie të jashtëzakonshme me drejtuesit e shkollës. Po ashtu është e domosdoshme që puna të projektohet, planifikohet, të identifikohen nevojat reale të komunitetit arsimor e veçmas të fëmijëve.

Për të realizuar këtë rol, anëtarët e Komitetit shkollor duhet të:

- identifikojnë nevojat e fëmijëve të shkollës (përmes bisedave – intervistave, anketimeve, kutisë së vërtetës;
- të bashkëbisedojnë dhe bashkëpunojnë me Këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;
- të bëjnë një plan veprimi për një vit shkollor;
- të mbahen mbledhje të rregullta mujore për planifikim dhe veprim;

Duke vepruar në këtë mënyrë, Komiteti shkollor do të shëndërohet në faktor të fuqizimit të drejtave të fëmijës në shkollë, rregullimit të raporteve nxënës mësimit dhe avancimit të cilësisë së mësimit.



Pse formohen komitetet shkollore?

Qëllimi:

Me qëllim të promovimit dhe të fuqizimit të të drejtave të fëmijës nëpërmjet procesit të edukimit dhe të arsimimit me projektin “Edukimi për të drejtat e fëmijës” është paraparë themelimi i Komiteteve Shkollore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Qëllimi kryesor i Komitetit shkollor është mbrojtja, respektimi dhe fuqizimi i të drejtave të fëmijës në shkollat e Kosovës.

Detyrat e Komitetit shkollor janë:

- Planifikimi i aktiviteteve lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në shkollë;
- Organizimi i tryezave, tribunave, debateve në temën të drejtat e fëmijës në shkollë;
- Organizimi i ekspozitave;
- Shënimi i përvjetorëve të datave që lidhen me të drejtat e njeriut dhe fëmijës;
- Organizimi i hartimeve me shkrim në temat e ndryshme që lidhen me të drejtat e njeriut dhe të fëmijës;
- Organizimi i ligjëratave në temat e ndryshme që lidhen me të drejtat e fëmijës dhe njeriut (p.sh. mbrojtja nga sida; droga dhe shëndeti; dëmet nga alkooli dhe duhani; ushqimi, ujë dhe mbrojtja e ambientit);
- Organizimi i studimeve të vogla për gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës;
- Mbledhjet mujore në bashkëpunim me Këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës (raportimet nga kutia e së vërtetës)
- Organizimi i vizitave në vende të ndryshme të cilat janë me interes për fëmijët e shkollës;
- Bashkëpunimi i nxënësve me nxënës të shkollave të ndryshme (shkëmbimi i përvojave, planifikimet për aktivitetet e përbashkëta, etj.);

Çfarë e bën të njohur komitetin shkollor?

Në bazë të aktiviteteve dhe vullnetit të madh të nxënësve për të punuar, natyrisht që Komiteti shkollor bëhet i njohur. Secila shkollë dhe secili Komitet shkollor i kanë të përbashkëtat dhe specifikat e veta.

Faktorët të cilët e bëjnë Komitetin shkollor të suksesshëm janë:


- Procesi demokratik i punës (ku nxënësve u lejohej që në mënyrë demokratike dhe me vet dëshirë të zgjedhin kohën dhe aktivitetin të cilin dëshirojnë ta punojnë);
- Takimet e rregullta të anëtarëve të Komitetit (tregon interesimin dhe vendosjen e fëmijëve për punë);
- Përpunimi i agjendës para çdo takimi (tregon seriozitetin e fëmijëve për punë);
- Aksionet e ndër marra nga vet fëmijët;
- Takimet të mbahen pas orarit mësimor (përveç në raste të jashtë zakonshme);
- Vendimet e marra në takime, tu interpretohen edhe nxënësve të tjerë;
- Të bashkëpunojnë edhe me Organizata tjera Qeveritare dhe Jo Qeveritare;
- Të ndërtojnë një fond të posaçëm për aktivitetet që i bën Komiteti shkollor (natyrisht që fondi të mos jetë obligues, por sipas mundësisë);
- Gjatë takimeve të ftohen edhe prindërit nëse është nevoja, (përveç Këshilltarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës të cilët duhet të jenë obligues në pjesëmarrje gjatë këtyre takimeve);
- Të ndihmojnë nxënësit tjerë në zhvillim;
- Të përkrahin atmosferën në mes nxënësve, stafit dhe drejtuesve të shkollës;
- Të bashkë punojnë për një disiplinë të mirë në shkollë;
- Të organizojnë përveç tjerash edhe aktivitete sportive, humanitare, turistike;
- Të monitorojnë gjendjen e të drejtave të fëmijës çdo tre muaj (me anë të anketave anonime, pyetësorëve, bisedave, etj...);



Informata, informata, informata...

Komiteti shkollor vendos, punon dhe mbron fëmijët dhe të drejtat e tyre. Por punën e lodhshme të komitetit shkollor nuk mund ta shohin të gjithë e as ta kuptojnë. Prandaj është mirë që çdo shkollë të ketë edhe letrën informative mujore. Kjo letër informative do ti ndihmojë në njohjen e punës, dhënien e informatave dhe shumë e shumë kënaqësi tjera do ti dhurojë secilit nga nxënësit i cili e lexon.

Letra informative mbledh të dhënat e punës së komitetit. Nuk kërkon shumë mjete dhe është një metodë e cila informon shkollën dhe komunitetin. Është metodë e cila lehtëson komunikimin me të tjerë.



■ *Andaj, nxitoni! Punoni letrën informative të shkollës çdo muaj. Tregoni se sa të zotë jeni. Tregoni se edhe ju dini të punoni.*

orari	e hënë	e martë	e merkur	e enjte	e premte	e shtunë
1						
2						
3						
4						
5						
6						

Si të mbajmë agjendë? Për çka na nevojitet agjenda? Si të përgatitet një agjendë?

Ta mbajmë së bashku!

Për të pasur më lehtë planifikimin e aktiviteteve tona, shumë më lehtë mund ti zhvillojmë ato nëse kemi një orar pune për secilën nga aktivitetet.

Agjenda është një gjë shumë e lehtë e cila e ndihmon Kryetarin e Komitetit si ti planifikojë punët me anëtarët e tij.

Çka dëshironi të bëni gjatë këtij viti mësimor? Të mësoni? Të argëtoheni dhe të kënaqeni?

Nëse keni qëllimet e juaja dhe dini të menaxhoni me kohën, ju do të keni kohë edhe për mësim, edhe për argëtim.

Agjenda e bën një gjë të mundur. Agjenda është një mjet shumë i mirë për të mbajtur dhe organizuar gjërat si duhet. E juaja është që vetëm ti shkruani gjërat të cilat doni t'i bëni gjatë javës, ti planifikoni mirë me kohën dhe të kujdeseni që ti përmbaheni orarit të caktuar për ndonjë aktivitet.

Raportet e komitetit shkollor me këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Cfarë duhet të bëjnë anëtarët e Komitetit shkollor dhe çfarë duhet të bëjnë Këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, që të kenë raporte të mira dhe harmoni me njëri tjetrin?

Natyrisht se përgjigja është shumë e thjeshtë. Bashkëpunimi i madh nga të dy palët duhet të jetë i vazhdueshëm në mënyrë që sukcesi i punës të mbizotërojë në shkollat ku ata punojnë. Këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës duhet vazhdimisht të kenë qasje në punën dhe aktivitetet e ndërmarra nga fëmijët. Përkrahja e tyre e pa përtueshme dhe e vazhdueshme u jep fëmijëve disponim të mirë dhe kënaqësi në punë. Këshilltarët duhet të bëjnë identifikimin e nevojave të fëmijëve për aktivitetet e duhura dhe tu ndihmojnë atyre në implementimin e këtyre aktiviteteve.

Një ndër çështjet me më së shumti rëndësi është ngritja e vetëdijes së nxënësve dhe mësimitdhënësve për rolin e formimit të Komitetit shkollor.

Pjesëmarrja e prindërve në komitetin shkollor

Një komitet i mirë formuar dhe aktiv ndihmon edhe mësimin në shkollë. Të gjithë prindërit dhe komuniteti janë të mirëseardhur në takimet e komitetit shkollor. Shkolla mirëpret prindërit të cilët në mënyrë vullnetare marrin pjesë në takimet e organizuara nga komiteti. Pjesëmarrja e prindërve ndihmon fëmijët në nxenie dhe jep një mundësi të përfshihen më shumë aktivitete me fëmijë.

Çka pritet nga prindërit?

- Të njihen me pozitën e shkollës dhe respektojnë vendimet e marra nga shkolla dhe komiteti shkollor;
- Përkrahin aktivitetet shkollore me respekt;
- Të punojnë së bashku me fëmijët dhe të mbjellin një ndjenjë përgjegjësie tek ata;
- Të kërkojnë donacione për të ndihmuar aktivitetet shkollore dhe punën e komitetit shkollor;
- Të inkurajojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në komitetet shkollore, kreativitetin e tyre për punë dhe zhvillojnë vetëbesim tek ata;

Mënyra e punës së komitetit shkollor

Mënyra se si duhet të punojë Komiteti shkollor është shumë e thjeshtë. Në bazë të planit të veprimit të cilin duhet dhe janë obligues ta bëjnë Këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, anëtarët e Komitetit shkollor dhe të gjithë nxënësit tjerë do ta kenë shumë më lehtë të punojnë. Në takimet e rregullta të Komitetit shkollor merret plani dhe definoheh aktivitetet të cilat do ti punojnë. Bëhen përgatitjet, definohet puna e secilit në mënyrë që në fund të gjithë të jenë të kënaqur. Këshilltarët monitorojnë vazhdimisht procedurat e aktiviteteve të ndërmarra, ndërsa anëtarët e Komitetit së bashku me nxënësit tjerë punojnë rreth aktivitetit të caktuar.

Takimet mujore të Komitetit shkollor, janë obliguese. Në raste të jashtëzakonshme takimet mund të jenë edhe më të shpeshta. Në qoftë se anëtarët e Komitetit vlerësojnë se takimet duhet të jenë më të shpeshta, atëherë ato mund ti mbajnë pa i angazhuar edhe Këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.



Atmosfera dhe relacionet në shkollë

Natyrisht, që për të pasur suksese në punën të cilën e bëjmë, duhet pasur relacione të mira me të gjithë e po ashtu edhe të mundohemi të krijojmë atmosferë dhe disponim të secili.

Për ta arritur këtë gjë, Komiteti shkollor duhet t'i plotësojë disa kritere, e ato janë:

- Respektimi i orarit të mësimi;
- Sjellja e mirë e secilit nxënës në shkollë;
- Mbrojtja e ambientit të shkollës dhe jashtë saj;
- Toleranca në mes të nxënësve dhe të mësimeve;
- Liria e shprehjes për secilin anëtar të Komitetit e po ashtu edhe të nxënësve të tjerë;
- Nxitja e punës vullnetare;
- Të zhvillohet dashuria ndaj mësimi;
- Të kërkojnë falje kur dikë e lëndojnë;
- Të bëhen sa më shumë debate dhe diskutime;
- Të ndihmojnë njëri tjetrin për t'i vlerësuar shprehjet e tyre të punës;
- Të dëgjohen të tjerët kur flasin me kujdes të plotë dhe me zemër;
- Të lavdërohet puna dhe mendimi i secilit;
- Të pranojnë njëri-tjetrin ashtu siç janë;

ËSHTË
ZGJIDHJA JUAJ -
NGRITENI
ZËRIN



Rregullat për siguri më të madhe në shkollë

Një shkollë e sigurt është ajo e cila fizikisht, emocionalisht dhe psikologjikisht i bën të tjerët të ndihen të sigurt. Kjo mund të arrihet me ndihmën e komitetit shkollor i cili duhet të:

- Kujdeset për secilin nxënës;
- Respektojnë ligjin dhe të tjerët;
- Respektojnë vlerat demokratike, të drejtat dhe përgjegjësitë;
- Respektojnë diversitetin kulturor;
- Respektojnë komunitetin, familjen dhe drejtuesit e shkollës;

Çka pritet nga nxënësit tjerë?

- Të respektojnë dhe ta ruajnë pasurinë e shkollës;
- Të respektojnë të vjetrit (mësuesit, drejtuesit e shkollës, prindërit);
- Të kujdesen për sjelljen e tyre;
- Të marrin përgjegjësi për veten;
- Të marrin iniciativa në mënyrë individuale ose grupe për aktivitete të ndryshme;

Adresimi dhe reagimi ndaj dhunës

Sigurisht që kur të përjetoni dhunë, keni frikë ndoshta të lajmëroheni te dikush, keni frikë se mos dhuna përsëri do të ushtrohet mbi ju dhe kështu ajo veç sa vjen e shtohet tek ju.

Mos keni frikë. Tregojuni të gjithëve nëse e ndieni se dikush ka ushtruar dhunë mbi ju.

Sot, ka shumë fëmijë dhe të rritur që përjetojnë dhunën. Në forma të ndryshme por që krijojnë strese të mëdha në njerëz. Sot, ka shumë që po ashtu dëshirojnë ta ndihmojnë këtë proces. Janë Institucionet, janë shkollat, familja, shoqëria e shumë e shumë vende tjera ku ju mund të drejtoheni dhe të kërkonin ndihmë. E tëra që duhet të bëni është të mos keni frikë. Të mos keni frikë nga e vërteta. Ta lajmëroni atë. Edhe nëse vehten nuk mund ta shpëtoni, të paktën shpëtoni të tjerët.

Këtë mund ta bëni përmes thirrjeve tuaja në telefonin e shpëtimit.

Shkolla, Institucionet e larta arsimore, qendra për punë sociale, Organizatat jo Qeveritare, Policia e Kosovës, Komiteti për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, e shumë e shumë organizata tjera, të gjithë mund të ndihmojnë në parandalimin e dhunës e cila ushtrohet nga ju. Andaj, duke ditur se ekzistojnë vende dhe vullneti i madh i shumë njerëzve për të ndihmuar kërkonin dhe adresohuni aty ku ju ndiheni më mirë, më të qetë dhe më të sigurt.

“ Ne të gjithë jemi të ndryshëm por,
të gjithë jemi të barabartë. ”



Çka të bëjmë ne që të ndihemi të sigurt?
Si ta parandalojmë dhunën në shkollë dhe shoqëri?
Si ta krijojmë një ambient të bukur për ne?

Janë këto shumë pyetje që parashtrohen prej nxënësve. Disa nxënës mendojnë shumë seriozisht për këto çështje e disa të tjerë as që mendojnë fare.

Si ti bindim edhe të tjerët të mendojnë? Shpesh bëhen këto pyetje nga fëmijët e ndryshëm. Por edhe nga të rriturit.

Atëherë, nuk na mbetet tjetër përveç që të bëjmë një zgjidhje. Ose të paktën të mundohemi të bëjmë zgjidhje.

Çka të bëjmë???

- Të krijojmë projekte dhe të kërkojmë donatorë;
- Të organizojmë aktivitete të ndryshme kulturore, sportive, etj.
- Të ndihmojmë komitetet shkollore;
- Ta përdorim kutinë e së vërtetës;
- Të krijojmë parlamentet shkollore ku do të dëgjohet edhe zëri ynë;
- Të bëjmë marrëveshje me media për sensibilizimin e shoqërisë për parandalimin e dhunës dhe delikuencës së të miturve;

Roli i shkollës në punën e komitetit shkollor

Shkolla luan rolin kryesor në punën e Komitetit shkollor. Shkolla është vendi i cili i trajton nevojat e fëmijëve për mësim, për nevojat sociale, emocionale, e po ashtu edhe nevojat e tyre për ndryshime dhe aktivitete që ndikojnë pozitivisht në formimin e fëmijëve. Qëllimi i shkollës duhet të jetë që ti mësojë fëmijët t’i kuptojnë porositë përmes përvojës në shkollë në mënyrë që dituritë e veta të mund t’i shfrytëzojnë dhe t’i zbatojnë ashtu siç duhet.

Të gjitha këto mund të arrihen me punën e palodhshme të stafit udhëheqës të shkollës, mësimitdhënësve dhe gjithë të tjerëve që punojnë në shkollë.

Stafi udhëheqës i shkollës duhet që fëmijëve të iu ofroj ndihmën maksimale për zhvillimin e aktiviteteve. Me ndihmën e tyre, nxënësit do të ndihen të lirë që shkollën e tyre ta shfrytëzojnë në mënyrën më të mirë për aktivitetet e parapara. Të ndihmosh fëmijët është profesion, jo vetëm punë. Krenaria për punën e tyre dhe përkushtimi ndaj tyre janë motivim për nxënësit që ata t’i shfrytëzojnë të gjitha burimet e mundshme. Stafi udhëheqës i shkollës duhet të jetë në rrjedha për punën e Komitetit shkollor, jo vetëm për arritjet e tyre në kuadër të lëndëve, por edhe lidhur me rolin dhe punën e bërë nga Komiteti shkollor dhe nga të gjithë nxënësit tjerë të asaj shkolle.

Mësimdhënësit mund të krijojnë atmosferën për të nxitur sjelljet pozitive të nxënësve.

Metodat më të mira që duhet t’i përdorin mësimdhënësit për ti ndihmuar dhe inkurajuar Komitetet shkollore janë:

- Të krijojnë ambientin që fëmijët ta ndiejnë veten të rëndësishëm dhe të vlefshëm;
- Të komunikojnë shumë me nxënësit e tyre;
- Të dëgjojnë me vëmendje mendimin e tyre;
- Të zbatojnë metoda të ndryshme me qëllim të ngritjes së suksesit të tyre;
- Të jenë në gjendje që çdo herë të lavdërojnë përpjekjet dhe përparimet e tyre;
- Të jenë në gjendje të iu ofrojnë zgjidhje dhe të iu ndihmojnë çdo herë kur ata kanë nevojë;
- Të jenë në gjendje të kenë besim në ndjenjat e tyre;



“ Nuk është gabim të jesh i ndryshëm nga të tjerët, është gabim të trajtohesh ndryshe nga të tjerët. ”



Intervistë me dy nxënës, anëtarë të komitetit shkollor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Nita Këpuska (14 years old)

“ It’s a privilege to be member of the School Comitee, you learn a lot and you can try to help pupils with difficulties. You know more things about the school and learn how to help people.”

Butrint Dëshishku (15 years old)

“ It’s interesting because we talk about the problems and try to solve them. We were particularly involved on finding solutions on problems. It’s important to work in group because you can’t solve the problems on your own. To work in group is also more fun.”

Interview by:
Gabrielle Arietano,
Program Officer, KEC